



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 18 shtator 2023  
Nr. ref.:RK 2258/23

## **VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS**

në

**rastin nr. KI13/23**

Parashtruese

**Marigona Djordjevic-Jakaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Marigona Djordjevic-Jakaj, me vendbanim në Gjermani (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës nuk konteston ndonjë vendim specifik të autoritetit publik, por konteston mosmbajtjen e një seancë gjyqësore nga ana e Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) e cila sipas saj është duke rezultuar në mosnxjerrjen e një vendimi gjyqësor për zgjidhjen e martesës së saj.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtrueses së kërkesës për “nxjerrjen e vendimit gjyqësor” nga ana e Gjykatës Themelore për zgjidhjen e martesës së saj. Në kërkesën e saj, parashtruesja e kërkesës nuk ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) asaj i janë cenuar.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e Punës nr. 01/2023 e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, në përputhje me rregullin 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së Punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së Punës nr. 01/2018 do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 26 janar 2023, parashtruesja e kërkesës përmes postës elektronike dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 6 shkurt 2023 Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.KSH.KI13/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 1 shkurt 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe bazuar në nenin 21 (Përfaqësimi) dhe nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës kërkoi nga ajo që të dorëzojë formularin plotësuar të kërkesës së Gjykatës dhe i kërkoi që të “[specifikojë] saktë se cilin vendim të autoritetit publik konkretisht po kontestoni para Gjykatës Kushtetuese, të cekni cilat të drejta dhe liri pretendoni se u janë cenuar dhe të bashkëngjitni vendimin e fundit të kontestuar së bashku me vendimet tjera apo dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me këtë kërkesë.”
9. Më 13 shkurt 2023, parashtruesja e kërkesës përmes komunikimit elektronik vetëm njoftoi Gjykatën se atë para Gjykatës Themelore e përfaqëson avokati I.R. (për të cilin

nuk dorëzoi as autorizim të vlefshëm të përfaqësimit në Gjykatë) se nga gjyqtari i rastit në Gjykatën Themelore nuk ka pranuar asnjë përgjigje në lidhje me padinë e saj për zgjidhjen e martesës dhe as përgjigje ndaj urgjencës për mbajtjen e seancës gjyqësore. Megjithatë, parashtruesja e kërkesës në Gjykatë nuk dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës dhe as nuk saktësoi se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë asaj i ishin cenuar.

10. Më 29 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

### **Përmbledhja e fakteve**

11. Nga dokumentacioni i bashkëngjitur në kërkesën e parashtrueses së kërkesës rezulton që e njëjta më 15 janar 2008 kishte lidhur martesë më bashkëshortin e saj.
12. Më 23 korrik 2022, parashtruesja e kërkesës përmes përfaqësuesit të saj ligjorë në Gjykatën Themelore kishte paraqitur padi për shkurorëzim/zgjidhje të martesës.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

13. Parashtruesja e kërkesës nuk konteston ndonjë vendim specifik të autoritetit publik, konteston mosmbajtjen e një seancë gjyqësore nga ana e Gjykatës Themelore, e cila sipas saj është duke rezultuar në mosnxjerrjen e një vendimi gjyqësor për zgjidhjen e martesës së saj.
14. Parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj specifikon se ajo më 23 korrik 2022 në Gjykatën Themelore ka parashtruar padi për zgjidhjen e martesës, dhe se nga kjo e fundit nga data e parashtrimin të padisë dhe pavarësisht kërkesës për urgjencë nuk ka marrë përgjigje apo ftesë për seancë gjyqësore.
15. Parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj specifikon se “po më cenohet e drejta për shkurorëzim martesë”.

### **Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës**

#### **Ligji**

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

#### **Rregullorja e punës**

Rregulli 25  
(Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve)

*2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:  
(...)*

*(c) autorizimin për përfaqësim;  
(...)*

*(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.*

Rregulli 54  
(Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

(...)

*(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:*

*(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën;*

(...)

### **Vlerësimi i kërkesës**

16. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 i të njëjtin nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
17. Megjithatë, përtej kriterëve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse kërkesa e parashtrueses së kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së saj, Gjykata rikujton se: (i) neni 48 i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave që të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë të jenë cenuar; si dhe (ii) neni 21 i Ligjit i cili përcakton që palët para Gjykatës përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala. Për me tepër, rregulli 32 i Rregullores së punës përcakton që kërkesa e parashtruesve të kërkesës duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
18. Në rastet kur kërkesat para Gjykatës nuk janë të kompletuara, bazuar në paragrafin 4 të nenit 22 të Ligjit, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Atëherë, kur palët përkatëse, nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë, bazuar në rregullin 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, duke marrë parasysh që kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave të saj ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë të njëjtën.
19. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që kërkesa e dorëzuar në Gjykatë më 26 janar 2023, ishte e paplotë, përkatësisht: (i) parashtruesja e kërkesës nuk kishte dorëzuar formularin e plotësuar të kërkesës në Gjykatë; (ii) nuk kishte specifikuar se cilin akt të

autoritetit publik ajo e konteston; (iii) kërkesës i mungonin të gjitha informatat relevante në kronologjinë faktike dhe procedurale të një rasti; (iv) dhe nuk kishte specifikuar se cilat të drejta dhe liri të garantuar me Kushtetutë asaj i ishin cenuar. Si rezultat i kësaj, Gjykata më 1 shkurt 2023 i kishte kërkuar parashtrueses së kërkesës që të dorëzojë formularin plotësuar të kërkesës së Gjykatës *duke specifikuar saktë se cilin vendim të autoritetit publik konkretisht e konteston para Gjykatës Kushtetuese, dhe të cekë cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe duke bashkëngjitur dokumentacionin relevant në lidhje me kërkesën e saj.*

20. Në vijim të kërkesës së Gjykatës, parashtruesja e kërkesës më 13 shkurt 2023 përmes komunikimit elektronik njoftoi Gjykatën se ajo para Gjykatës Themelore përfaqësohej nga avokati I.R. për të cilin as nuk e kishte bashkëngjitur asnjë autorizim për përfaqësim në Gjykatë, si dhe specifikoi se përkundër kërkesës së saj për urgjencë të dorëzuar në Gjykatën Themelore, kjo e fundit nuk i kishte dorëzuar asaj as përgjigje dhe as ftesë për mbajtje të seancës gjyqësore përkitazi me padinë e saj për zgjidhje të martesës.
21. Megjithatë, përkundër kërkesës specifike të Gjykatës, parashtruesja e kërkesës në përgjigjen së saj, nuk i kishte bashkëngjitur formularin e plotësuar të kërkesës, dhe se nuk kishte specifikuar se cilat të drejta dhe liri të garantuar me Kushtetutë asaj ishin cenuar. Për më tepër, ajo në përgjigjen e saj kishte deklaruar se përfaqësohej nga një avokat, për të cilin as nuk kishte dorëzuar autorizimin e vlefshëm për përfaqësim në Gjykatë.
22. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson, se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është e paplotë, përkundër kërkesës së Gjykatës për ta plotësuar dhe saktësuar kërkesën e saj të parashtruar në Gjykatë (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, KI121/21, parashtrues *Bajram Hasani*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 23 shtatorit 2021, paragrafi 38; KI135/21 *Isuf Musliu*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 10 shtatorit 2021, paragrafi 35; dhe KI101/21, *N.T.SH. Morina B*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).
23. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të mosplotësimit të kërkesës dhe saktësimit të kërkesës së të parashtruar në Gjykatë, ashtu siç kërkohet me nenet 21, 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 25 (2) (c) dhe (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës, dhe rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të nenit 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 25 (2) (c) dhe (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës, më 29 gusht 2023 njëzëri:

### VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. TË KONSTATOJË që Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**

  
Safet Hoxha

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



  
Gresa Caka-Nimani